



DEKLARATE SHTYPI

Ekspertët europianë publikojnë raportin për rehabilitimin e monumenteve Pas-Bizantine në Voskopojë e Vithkuq

13 dhjetor 2018 - Europa Nostra, organizata kryesore e trashëgimisë në Europë dhe **Instituti i Bankës Europiane të Investimeve** lëshoi sot një [raport teknik dhe financiar](#) që përmban një plan veprimi për të restauruar dymbëdhjetë ndërtesa religjioze Pas-Bizantine në Voskopojë dhe Vithkuq në rajonin e Korçës në Shqipërinë jug-lindore. Ndërtesat fetare u listuan ndërmjet 7 Më të Rrezikuara Vendet Trashëgimi në Europë në vitin 2018 ([7 Most Endangered heritage sites in Europe in 2018](#)), pas një nominimi të bërë nga **Fondacioni "E Shkuara për të Ardhmen"**.

Raporti u formulua në bazë të rezultatit të misionit katër-ditor në Shqipëri, të ndërmarrë më 18-21 shtator 2018. Gjatë misionit, ekspertë të trashëgimisë dhe të financiare nga Europa Nostra dhe Instituti i Bankës Europiane të Investimeve vizituan strukturat religjioze Pas-Bizantine në Voskopojë dhe Vithkuq dhe u takuan me autoritetet kombëtare – përfshirë Drejtorin në Ministrinë e Turizmit dhe Mjedisit **Evis Koplaku**, Ministren e Kulturës **Mirela Kumbaro**, përfaqësuesin kryesor të Kishës Ortodokse në Korçë, Voskopojë dhe Vithkuq **Johan Pelushi**, organizatat joqeveritare të shoqërisë civile dhe aktorë të tjerë joqeveritarë—, me qëllim për të mobilizuar përpjekjet për të shpëtuar këto ndërtesa ikonike religjioze.

Ky grup i dymbëdhjetë ndërtesave religjioze përbëhet nga dhjetë kisha dhe dy manastire, ku më të hershmet datojnë nga fundi i shekullit të 14-të dhe më të shumtat datojnë nga shekujt 17-të dhe 18-të. Këto kisha përfaqësojnë një formë të re dhe unike arkitekturore të basilikës, duke kombinuar traditat Bizantine dhe Otomane. Afresket janë më përfaqësueset e artit kishtar të shekujve 17-të -18-të në Ballkan dhe janë kryevepra të stilit Pas-Bizantin.

"Këto kisha janë të veçanta për nga historia dhe forma e tyre dhe përmbajnë vepra arti të mrekullueshme të cilat meritojnë të restaurohen si trashëgimi kulturore si dhe për përfitimet e mundëshme të turizmit në këtë rajon të pazhvilluar. Një mundësi për të financuar vepra të tilla po bëhet e mundur dhe kjo duhet të arrihet duke siguruar përgatitjen e një dosje dhe programi të plotë si dhe duke adoptuar disa përmirësime në burime, cilësi dhe koordinim siç rekomandohet", thekson raporti.

"Ministria e Kulturës është përfshirë veçanërisht në fillimin e restaurimit të këtyre monumenteve në rajonin e Korçës nëpërmjet Departamentit të saj Rajonal të Trashëgimisë Kulturore, pjesë e Institutit të Trashëgimisë Kulturore me qendër në Tiranë. Shumica e dymbëdhjetë ndërtesave kanë pasur disa restaurime thelbësore mbrojtëse të ndërmarrura kohët e fundit. Financimi dhe burimet kanë qenë të kufizuara dhe punët e kryera duket se janë përshtatur pasi burimet janë bërë të disponueshme, në vend që të ishin pjesë e një programi të strukturuar afatgjatë. Megjithatë, veprat duket se janë bërë në mënyrë racionale duke u kushtuar vëmendje fillestare mbrojtjes duke riparuar strukturat e çatisë dhe gjithashtu në tërësinë kryesore strukturore të ndërtesave. (...) Ndërsa shumë punë të dobishme janë ndërmarrë, jo gjithçka ka qenë në standardin e lartë të pritshëm për këto monumente të jashtëzakonshme," vëren raporti.

Në raport janë paraqitur veprimet dhe rekomandimet e propozuara si më poshtë:

- Një program strategjik duket që mungon. Kujdes duhet të vendoset në zhvillimin e një programi të tillë racionale në mënyrë që të sigurohen fondet dhe të planifikohen e programohen në mënyrë optimale. Një [Rivlerësim i tillë Strategjik dhe krijimi i një Programi të Përgjithshëm](#) propozohet si një veprim i parë.
- Ky Program i Përgjithshëm duhet të jetë praktik dhe mjaft fleksibël. Duhet të përfshijë diskutime dhe bashkëpunim me palët e tjera të interesuara për të fituar mbështetje. Kisha Ortodokse, Bashkia e

Korçës, përfaqësuesit lokalë të fshatit dhe ekspertët vendorë duhet të të angazhohen më aktivisht e të inkurajohen të kontribuojnë, dhe për këtë duhen bërë përpjekje më të mëdha. Një formë e kontakteve të strukturuar, për shembull nëpërmjet një Komiteti Koordinues nën drejtimin e Institutit të Trashëgimisë Kulturore (ITK), do të ishte e dobishme për të përmirësuar vendim-marrjen dhe për të përfshirë vendorët më afër me programin. Marrëveshja është e nevojshme në një program mirëmbajtjeje pas restaurimit.

- Disa çështje teknike ku ka patur mangësi (p.sh. përmbytjet e kishave, riparimet e dobëta të çative, programimi i punimeve - çarjet serioze ndërsa bëheshin riparimet e çative) kërkojnë rishqyrtim dhe përmirësim për të shmangur ripërsëritjen. Rekomandohen përmirësimi i përzgjedhjes së kontraktuesve, specifikime më të prera dhe mbikëqyrje më e fuqishme në vend. Përdorimi i lejuar së fundmi i konsulentëve të jashtëm duhet të inkurajohet për të ndihmuar në zgjidhjen e këtyre çështjeve.
- Restaurimi i afreskeve është tani aktiviteti kryesor, që përfaqëson më shumë se 70% të punës së re. Shkalla e punës së propozuar është dukshëm më e madhe se më parë dhe do të kërkojë burime shtesë, pasi deri tani restaurimi i afreskeve është kryer nga ekipi i vogël i dedikuar brenda Drejtorisë Rajonale të Trashëgimisë Kulturore (DRTK) në Korçë.
- Përveç kësaj, rekomandohet ritje e aftësive për të përmirësuar teknikat e restaurimit, pasi vërehen disa dobësi. Një formë trajnimi ose workshop-e të strukturuar nga ekspertë të jashtëm do të ishin shumë të dëshirueshme, të ngjashme me ato që tashmë janë kryer. Duhet të inkurajohet lëshimi për studiuesit e dokumentacionit shkencor me akses krejt të hapur ndaj të dhënave.
- Përpjekje të veçanta duhet të bëhen për të siguruar që financimi përmes mekanizmave të ndryshëm të disponueshëm nga Bashkimi Europian dhe Banka Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH) të përdoren për të mirën e projektit. Që kjo të arrihet janë të rëndësishme përgatitjet dhe prezantimet cilësore, si dhe fazat optimale të veprimeve dhe vendim-marrjeve.
- Projekti duhet të integrohet në strategjinë e zhvillimit të Korçës në nivel më të gjerë. Ky duhet të fokusojë jo vetëm restaurimin e kishave, por dhe impaktin ekonomik të këtij restaurimi. Projekti mund të ndihmojë të mbështesë me impakt pozitiv konsolidimin dhe zgjerimin e sektorëve ekonomikë të punëve-intensive, të tilla si hotelet e vogla/akomodim dhe ndërtim. Këto ndikime duhet të inkurajojnë mbështetjen për qasje më të mirë në rrugë, infrastrukturë dhe zhvillim të turizmit në rajon.

Sipas raportit, projekti i përgjithshëm i rehabilitimit për dymbëdhjetë ndërtesa fetare vlerësohet të kushtojë rreth **4.3 milion euro**. Këto vlerësime janë paraprake dhe do të duhet të konfirmohen kur të vihen në dispozicion më shumë detaje për punët e pranishme. Janë llogaritur dy alternativa, përkatësisht një Fazë Prioritare për tre kisha që kushton 1.4 milion euro dhe një program për të gjitha kishat e Voskopojës e Vithkuqit me 2.5 milion euro. Është propozuar një qasje me faza me një Studim Fillestar për të dhënë një pamje të përgjithëshme strategjike për të orientuar programin. Kjo do të pasohet nga një Fazë Përgatitore me kqyrje më të hollësishme për të përcaktuar më qartë punën që kërkohet dhe për të finalizuar prioritetet para nisjes së projektit.

Raporti i plotë teknik dhe financiar mund të shkarkohet [këtu](#).

KONTAKTE PER SHTYPIN

Fondacioni “E Shkuara për të Ardhmen”

Kliti Kallamata

E: past4future@gmail.com

T: +355 692147022

Europa Nostra

Joana Pinheiro, Zyrtare e Komunikimeve

E: jp@europanostra.org

T: +31 70 302 40 55

PËR MË SHUMË

<http://7mostendangered.eu/>

www.europanostra.org/7-most-endangered-news

twitter.com/europanostra

youtube.com/user/EuropaNostraChannel

Informacion i sfondit

Programi 7 Më të Rrezikuarit

Programi 7 Më të Rrezikuarit ([The 7 Most Endangered programme](#)) identifikon monumentet dhe vendet trashëgimi të rrezikuara në Europë dhe mobilizon partnerët publikë dhe privatë në nivel lokal, kombëtar dhe europian për të gjetur një të ardhme të suksesshme për këto site. Programi ka filluar në 2013 nga **Europa Nostra** me **Instituti i Bankës Europiane të Investimeve** si partner themelues dhe Banka e Zhvillimit të Këshillit të Evropës si partner shoqëruar. Ajo u frymëzua nga një projekt i suksesshëm i ngjashëm i drejtuar nga Trusti Kombëtar Amerikan për Ruajtjen Historike. 7 Më të Rrezikuarit nuk është një program financimi. Ai është një katalizator për veprim dhe nxit "fuqinë e shembullit". 7 Më të Rrezikuarit mbështetet nga programi i **Europës Krijuese** të Bashkimit Europian, si pjesë e projektit të rrjetit Europa Nostra "Trashëgimi e Përbashkët - Vlera të Përbashkëta".

Që nga viti 2013, janë përzgjedhur si të të kërcënuara 29 monumente dhe vende të trashëgimisë nga 19 vende të Evropës për në 7 Më të Rrezikuarat. Lista e parë u botua në vitin 2013, lista e dytë në 2014, lista e tretë në vitin 2016 dhe lista e katërt në vitin 2018, gjatë Vitit Europian të Trashëgimisë Kulturore. Në 2016, Laguna e Venecias në Itali u shpall vendi i trashëgimisë më të rrezikuar në Europë.

Një panel ndërkombëtar këshillimor, i përbërë nga specialistë në histori, arkeologji, arkitekturë, konservim dhe financë, takohet për të diskutuar aplikacionet e dorëzuara në programin 7 Më të Rrezikuar dhe për të përzgjedhur monumentet dhe vendet trashëgimi më të kërcënuara. Lista përfundimtare e 7 vendeve trashëgimi zgjidhet nga Bordi i Europa Nostra.

Ekspertët e trashëgimisë dhe ata financiarë nga Europa Nostra dhe Instituti i Bankës Europiane të Investimeve ndërmarrin misionin në 7 vendet trashëgimi, së bashku me propozuesit. Ekipet multidisiplinore vlerësojnë vendet trashëgimi dhe ndihmojnë në formulimin e një plani veprimi të mundshëm për secilin prej tyre, në bashkëpunim të ngushtë me palët publike dhe private të vendit. Rezultatet dhe rekomandimet e këtyre misioneve përmbledhen në raportet teknike dhe financiare. Partnerët e programit ndihmojnë në zbatimin e këtyre raporteve ([reports](#)).

Europa Nostra

[Europa Nostra](#) është federata pan-europiane e OJQ-ve të trashëgimisë e cila mbështetet gjithashtu nga një rrjet i gjerë i organeve publike, kompanive private dhe individëve. Duke mbuluar më shumë se 40 vende në Europë, organizata është zëri i shoqërisë civile të angazhuar për ruajtjen dhe promovimin e trashëgimisë kulturore dhe natyrore të Evropës. E themeluar në vitin 1963, sot njihet si rrjeti më përfaqësues i trashëgimisë në Europë. Plácido Domingo, këngëtar i njohur i njohur botëror, është President i organizatës.

Europa Nostra bën fushatë për të ruajtur monumentet, vendet trashëgimi dhe peizazhet e rrezikuara të Evropës, në veçanti përmes programit 7 Më të Rrezikuar ([7 Most Endangered programme](#)). Ajo shpall përsosmërinë përmes Çmimit të BE-së për Trashëgiminë Kulturore / Çmimet Europa Nostra. Ajo gjithashtu kontribuon në formulimin dhe zbatimin e strategjive dhe politikave europiane që lidhen me trashëgiminë, nëpërmjet një dialogu të strukturuar me institucionet europiane dhe koordinimin e Aleancës Europiane të Trashëgimisë 3.3. Europa Nostra ka promovuar me forcë dhe po kontribuon në mënyrë aktive në Vitin Europian të Trashëgimisë Kulturore 2018 ([European Year of Cultural Heritage](#)).

Instituti i Bankës Europiane të Investimeve

Instituti i Bankës Europiane të Investimeve ([European Investment Bank Institute](#) - EIBI) u krijua në kuadër të Grupit EIB (Banka Europiane e Investimeve dhe Fondi Europian i Investimeve) për të promovuar dhe mbështetur iniciativat sociale, kulturore dhe akademike me palët europiane dhe publikun e gjerë. Kjo është një shtyllë kryesore e angazhimit të komunitetit dhe të qytetarisë të Grupit të EIB-it. Më shumë informacion në <http://institute.eib.org>

Europa Krijuese

Europa Krijuese ([Creative Europe](#)) është programi i BE-së që mbështet sektorët kulturorë dhe krijues, duke u mundësuar atyre që të rrisin kontributin e tyre në vende pune dhe në rritje. Me një buxhet prej 1.46 miliard euro për vitet 2014-2020, ai mbështet organizatat në fushën e trashëgimisë, arteve të interpretimit, arteve të bukura, artit ndërdisiplinor, botimit, filmit, televizionit, muzikës dhe video lojrave si dhe dhjetëra mijëra artistë, profesionistë kulturorë dhe audiovizualë. Financimi u lejon atyre të veprojnë në të gjithë Europën, për të arritur audienca të reja dhe për të zhvilluar aftësitë e kërkuara në epokën dixhitale.

Fondacioni "E Shkuara për të Ardhmen"

Fondacioni "E Shkuara për të Ardhmen" është një organizatë joqeveritare e themeluar në vitin 2002 me qëllim mbrojtjen, studimin, ruajtjen dhe restaurimin e monumenteve historike dhe trashëgimisë kulturore. Qendra e fondacionit është në Korçë, në juglindje të Shqipërisë - një zonë me numër të madh dhe shumëllojshmëri të monumenteve historike, ndërsa veprimtaria e fondacionit shtrihet në të gjithë Shqipërinë. Fondacioni ka kontribuar në shumë projekte, duke përfshirë studime dhe vepra që kanë të bëjnë me mbrojtjen e arkitekturës dhe teknologjisë paraindustriale në Shqipëri, studimet arkeologjike mbi monumente parahistorike, veprat konservuese mbi artin dhe arkitekturën e monumenteve bizantine dhe pas-bizantine si dhe mbrojtjen e zonave urbane.